



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

Datë 28.02.2023

NJOFTIM

Për shtesa e heqje në rendin e ditës në mbledhjen e radhës

Në mbështetje të nenit 53, pika 2, të nenit 57 pika 2/c të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 48, nenit 49, neni 55, të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, Këshilli Bashkiak Durrës,

NJOFTON:

NË MBLEDHJEN E RADHËS, QË DO TË MBAJ KËSHILLI BASHKIAK ME DATË 28.02.2023, ORA 12:00, ME KËRKESË TË BASHKISË DURRËS, DO TË KEMI SHTESA E HEQJE NË RENDIN E DITËS SI MË POSHTË:

SHTOHEN NË RENDIN DITËS PIKAT:

Pika 14 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË 15 FAMILJEVE PËRFITUESE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË, TË MBETURA TË PASTREHA, SI PASOJË E SHEMBJES SË BANESAVE TË TYRE, SHKAKTUAR NGA PRISHJA E DETYRUAR, SIPAS EKSPERTIZAVE TË THELLUARA, HARTUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË
Pika 15 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.1, DATË 13.01.2023, “PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 48342000 (DYZETË E TETË MILION E TREQIND E DYZETË E DYMIJË) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, SIPAS TABELËS SË HARTUAR NGA GRUPI I PUNËS, I NGARKUAR PËR KRYERJEN E VLERËSIMIT PARAPRAK, DHE ËSHTË PJESË E KËTIJ VENDIMI, QË

	PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: “PROJEKT ZBATIMI PËR NDËRTIMIN E SHETITORES SË PLAZHIT DURRËS, NGA URA E DAJLANIT DERI NË GODINËN E KOVALISHENCËS”, I NDRYSHUAR
Pika 16 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SHTATË PARAPRAKE TË 54 FAMILJEVE, QË KANË HUMBUR SHTËPITË INDIVIDUALE SI PASOJË E SHEMBJES NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONA VE TË REJA
Pika 17 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 5, RRASHBULL, SUKTH, KATUND I RI, BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 18 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE SUKTH, OBJEKTET E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

HIQET NGA RENDI I DITËS PIKA 5.

Pika 5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E KRIJIMIT TË KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJ
---	---

Komisionet, që do të shqyrtojnë projektvendimet do të jenë:

Në mbështetje të nenit 33, neni 34/1, neni 77 /8, të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, anëtarët e Komisioneve të Këshillit Bashkiak pasi shqyrtojnë me njëri tjetrin projektvendimin përkatës, dërgojnë me email propozimin e tyre (RAPORTIN) mbi projektvendimin, sipas grafikut të mëposhtëm.

Datë 28.02.2023

Nr.	Komisionet që shqyrtojnë projektvendimet	Projektvendime pikat e rendit të ditës	Vendi i mbajtjes së mbledhjes	Ora
1.	Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike	14, 15, 16, 17, 18	Zyra e Sekretariatit ose me mjete	10.00

			të komunikimit elektronik	
2.	Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor	15	Zyra e Sekretariatit ose me mjete të komunikimit elektronik	10.45
3.	Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike	14, 16, 17, 18	Zyra e Sekretariatit ose me mjete të komunikimit elektronik	11.00
4.	Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimi Tokës	14, 16, 17, 18	Zyra e Sekretariatit ose me mjete të komunikimit elektronik	11.30

SEKRETARE KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS

Dorina Milja

